



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202101257/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

**Lënda:** *Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë/Komisariatit e Policisë Shkodër.*

**Drejtuar:** **Drejtues i parë Hamdi FJORA**  
**Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë në Shkodër**

**SHKODËR**

**Kryekomisar Paulin ÇUPI**  
**Shef i Komisarit të Policisë Shkodër**

**SHKODËR**

**Për dënim:** **Drejtues Madhor Gledis NANO**  
**Drejtor i Përgjithshëm i Policisë të Shtetit**

**TIRANË**

*Të nderuar,*

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 datë 25.06.2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve, zhvilloi një inspektim në Komisaratin e Policisë në Shkodër.

Inspektimi u krye në datën 29.09.2021, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Hazbi Selita, z. Besnik Deda, znj. Nertila Qafzezi dhe znj. Gloria Çarkaxhiu, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", në Procedurën Standarde "Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, në Procedurën Standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së

Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i vitit të kaluar.

Avokati i Popullit, bazuar në konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetasit e privuar nga liria, grupi i inspektimit, u takua me shefin e rendit z. Pjerin Lazeri, i cili u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, shefi i rendit informoi për gjendjen e kushteve në të cilën ndodhen ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë pranë këtij komisariati, zbatimin e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore nga punonjësit e policisë të komisariatit për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto ambiente, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me qëllimin e vizitës monitoruese, inspektoi ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, zyrat e punonjësve të policisë të cilët kryejnë veprime proceduriale me shtetasit e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar, si dhe kontrolloj dhe administroi dokumentacionin ku pasqyroheshin veprimet e kryera me këta persona.

Theksojmë se, drejtuesit dhe punonjësit e shërbimit të Komisarariatit të Policisë Shkodër me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë inspektimit që u zhvillua në ambientet e këtij institucioni.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm, rezultoi se:

- **Ishte plotësuar rekomandimi**, i ndërtimit të godinës së re të Drejtorisë Vendore të Policisë dhe Komisarariatit të Policisë Shkodër (Kontratë e cila sipas afateve kohore duhet të kishte përfunduar punimet për një periudhë 24 mujore, konkretisht 03.10.2020), sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, aktit të procedurës standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në policisë”, miratuar me Urdhrin Nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr.925, datë 18.07.2019.
- **Ishte plotësuar rekomandimi**, për pajisjen me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin në Komisariatin e Policisë Shkodër.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

- **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër.

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Në Komisarjatin e Policisë Shkodër, ambientet e shoqërimit në tërësi ishin të ndërtuara sipas kritereve të parashikuara në procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ato ndodheshin në katin e parë të godinës, dhe përbëheshin nga tre dhoma shoqërimi një (1) për persona të rritur, një (1) për gra dhe një (1) për të mitur.

Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe 4x4 m<sup>2</sup>; me hapësirë të mjaftueshme për qëndrimin e personave të shoqëruar. Dritaret e dhomave lejonin mundësi për realizimin e ajrimit e ndriçimit të plotë natyral. Dhomat ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjienike. Kapaciteti i ambientit të shoqërimit ishte për mbajtjen dhe qëndrimin maksimalisht të 12 personave, të ndara sipas dhomave për 4 persona për secilën dhomë.

Dhomat e shoqërimit kishin ndriçim nga rrjeti elektrik dhe ishin të pajisura secila me 4 karrige, tavolinë të fiksuara në dysheme për qëndrimin ulur të të shoqëruarve. Në hyrje të korridorit ndodheshin 3 tualete të ndara më vete për meshkuj dhe femra dhe për punonjësit e policisë sipas standardeve të miratuara. Ato ishin të pastra dhe të pajisur me dushe, lavaman dhe ujë të rrjedhshëm 24 orë. Korridori i këtij ambienti ishte i monitoruar me kamera. Në dhomat e shoqërimit ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar.

Në hyrje të korridorit të dhomave të shoqërimit ndodhej një dhomë e ndarë me xham në mes, e cila shërben për njohjen e personave në hetim për veprat penale nga organi i prokurorisë apo nga oficerët e policisë gjyqësore në procedimin e një vepre penale, e cila ishte e pajisur me tavolina, karrige dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, ndaluar/të arrestuar si dhe ishin të instaluar kamerat e monitorimit.

Marrja në pyetje dhe intervistimi i personave të shoqëruar, në mungesë të një ambienti më vete, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Theksojmë se, dhomat e shoqërimit dhe zyrat e punës të punonjësve të policisë, nuk monitoroheshin nga sistemi i kamerave.

Në kuadër të projektit të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së shtetit dhe i zbatuar nga subjekti përkatës i prokuruar për këtë qëllim, konstatohet se nuk respekton standardet e kërkuar në lidhje infrastrukturën e nevojshme të krijimit të ambienteve sipas ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, në Procedurën Standarde “*Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, në Procedurën Standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.

Institucioni i Avokatit të popullit çmon të nevojshme për ndërprerjen e menjëhershme të praktikës së deritanishme të strukturave të Policisë së Shtetit për projektet për investim

nëpër institucionet e privimit të lirisë që nuk plotësojnë standardet e garantimit e lirisë dhe të drejtave të njeriut gjatë shoqërimit apo intervistimit të personave në mjediset policore ose në vende të tjera, sipas kushteve dhe rasteve të përcaktuar ligj.

Në Komisarriatin e Policisë Shkodër, gjatë periudhës 01.01.2021 deri më 29.09.2021 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evindetuar në regjistrin e shoqërimit **714** persona, ku saktësisht **702** shtetas madhor, **7** shtetas të mitur dhe **5** shtetase gra të shoqëruar në konflikt me ligjin, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe 112/1 të ligjit për Policinë e Shtetit. Në momentin e inspektimit, **nuk kishte asnjë shtetas** në dhomat e shoqërimit.

Gjithashtu, na u referua se personat e shoqëruar nga policia janë të informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore / procedurale që ata kanë. **Avokati i Popullit kërkon** dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore që në momentin e hyrjes në Komisarriat.

Nga verifikimi i regjistrit të marrjes dhe dorëzimit të personit të shoqëruar dhe kopjeve të proceverbaleve të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, në rubrikën me shënimet në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi se, për vitin 2021 nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar.

Gjithashtu, u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisarriatin e Policisë Shkodër, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

Gjatë inspektimit, ju kushtua një vëmendje e veçantë dhe zbatimit të masave të protokollit shëndetësor për parandalimin e COVID-19 në mjediset e komisarriatit. U evidentua se, punonjësit e policisë ishin të pajisur me maska mbrojtëse dhe ruanin distancën fizike me njëri tjetrin. Në vende të aksesueshme (korridore) ishin vendosur dezinfektant për pastrimin e duarve. Gjithashtu, masat mbrojtëse ndaj COVID-19 zbatoheshin edhe nga personat kur hyjnë në dhomat e sigurisë dhe ato të shoqërimit, si dhe në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Furnizimi me maska mbrojtëse dhe dezinfektantët për duart kryhej periodikisht çdo 3 muaj nga DVP Shkodër, por një pjesë e tyre ishin siguruar nga edhe donacionet e ofruara nga subjekte private. Ambientet e zyrave të punës, dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, ambientet rreth komisarriatit si dhe automjetet, ishin dezinfektuar periodikisht edhe nga institucionet vendore të qarkut Shkodër.

### **Ambientet e sigurisë/kushtet e tyre dhe trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve**

Dhomat e sigurisë në Komisarriatin e Policisë Shkodër ishin ndërtuar në tërësi sipas kërkesave të parashikuara në Procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

Ambientet e sigurisë ishin në katin e parë të godinës dhe ishin gjithsej 14 dhoma sigurie me kapacitet 16 persona. Konkretisht 12 dhoma me nga një person secila ndërsa 2 dhoma të tjera me 2 persona, të ndara në dhoma për të rritur, në dhoma për gra dhe në dhoma për të mitur, sipas kërkesës së ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Aktit të procedurës standarde: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evindetimi dhe zgjidhja e kërkesave të tyre”, miratuar me urdhrin nr.925, datë 18.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Sipas kriterëve për ndërtimin e dhomave të sigurisë<sup>1</sup>, normat dhe parametrat teknike, jetësore e të sigurisë për një person të arrestuar/ndaluar janë që sipërfaqja e përgjithshme e ambientit duhet të jetë jo më pak se 10 m<sup>2</sup>, e cila duhet të ndahet në ambient qëndrimi me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>. Lartësia e këtyre ambienteve duhet të jetë jo më pak se 2.5 m. Ndërkohë, nga inspektimi rezultoi se, dhomat në ambientin e sigurisë në Komisarriatin e Policisë Shkodër, plotësojnë kriteret e mësipërme.

Dritaret e dhomave mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Këto ambiente ishin të pajisura me tualete brenda dhe lavamanë. Gjithashtu, dhomat kishin orenditë e nevojshme për jetesë, si krevat, dyshek, batanije dhe jastëk, të cilët ishin në gjendje të mirë dhe të pastra.

Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larje e pastrim të vazhdueshëm në paradhomë, ndërsa për larjen e trupit kishte ambient të posaçëm (2 dushe me ujë të ngrohtë), i cili ndodhej në korridor. Dushet ishin funksionale dhe punonin me sistem qëndror, po ashtu në paradhomën e dusheve kishte dhe tualet të përbashkët, i cili ishte i pajisur me të gjitha pajisjet që shërben për këtë qëllim.

Në ambientet e sigurisë kishte sistem ngrohjeje/ftohje me sistem qëndror sipas kushteve klimaterike, sikurse parashikohet edhe në procedurat standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar.

Në çdo dhomë kishte zile të emergjencës, e cila mundësonte komunikimin me shërbimin e policisë në një moment nevojë apo emergjence. Në korridorin e ambientit të sigurisë kishte aparat telefonik fiks dhe citofon për përdorim nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Ambienti i sigurisë kishte burim rezervë energjie me gjenerator më vete.

Në ambientin e sigurisë ndodhej dhe dhoma e mjekut që kryen vizitat mjeksore, mjek i emëruar në strukturën të forcave të ndërhyrjes së shpejtë (FNSH) Shkodër. Ajo ishte e pajisur me orenditë e nevojshme si shtrat, tavolinë, karrige, raft dhe frigorifer për mbajtjen e medikamenteve mjeksore për persona të ndaluar/arrestuar në Komisarriatin e Policisë Shkodër.

Gjithashtu kishte edhe një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët dhe pyetjen e tyre nga oficerët e policisë gjyqësore, e cila ishte e monitoruar me sistemin e kamerave. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige të fiksuara në dyshe.

---

<sup>1</sup> Kreu VIII, pika 3 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesës/ankesave të tyre”.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me kamera për 24 orë.

Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë dhe personat e arrestuar rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim 3 (tre) herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në vendimin nr. 189, datë 15.03.2017 “Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre”. Ushqimi përgatitej nga një subjekt privat në bazë të kontratës së lidhur me të dhe ofrohej me shërbim catering.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve, që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë. Nga informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë na u sqarua se të ndaluarve/arrestuarve u jepeshin produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Në Komisarlatin e Policisë Shkodër, gjatë periudhës 01.01.2021 deri më 29.09.2021 ishin të ndaluar, të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e personave të arrestuar/ndaluar 307 persona, me probleme me ligjin, sipas përcaktimeve të bëra në nenit 112/2 të ligjit për Policinë e Shtetit. Në momentin e inspektimit, **nuk kishte asnjë shtetas** në dhomat e sigurisë.

Nga informacionet e grumbulluara gjatë inspektimit, nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë ndaj shtetasve të ndaluar/arrestuar me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Në zbatim të Ligjit Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.938, datë 24.07.2019, çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi e sigurie, duhet të jetë e pajisur ndër të tjera, edhe me regjistrat përkatës. Nga inspektimi rezultoi se, regjistrat ishin të mbajtur në rregull, ishin të sekretuar dhe të plotësuar sipas rubrikave.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë në Shkodër, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” konform me procedurat standarde për rregullat teknike të shoqërimit në polici dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë.<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup> Kreu VII, procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhërin Nr.938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në këtë komisariat ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën që në momentin e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë.

Avokatit të Popullit, duke marrë shkas nga trajtimi i ankesave individuale, rasteve me iniciativë, si dhe nga inspektimet e kryera për këqyrjen e regjistrave që administrohen nga organet e Policisë së Shtetit, ka rekomanduar se, në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit, duhet të vihet ora e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë dhe jo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale respektivisht nenet 144, 250 dhe 259 të tij, si dhe neni 109, pika 4 e ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Nga inspektimi, u konstatua se në këtë komisariat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për periudhën që kryhej inspektimi, **nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë.**

Në Komisaratin e Policisë Shkodër, u konstatua gjithashtu se kishte edhe regjistër për takimet me avokatin ose prokurorin, regjistër të vizitave mjekësore, regjistër të shoqërimit të personave në ndaluar në gjykatë apo në institucione të tjera, regjistër të marrjes në pyetje nga prokurorët e çështjes, si dhe karta me të drejtat e personave të ndaluar ose të arrestuar në gjuhën shqipe dhe në 8 gjuhë të huaja, të cilat mbaheshin në dhomën e punës dhe administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Gjithashtu posterat e vendosur në institucion, pasqyrojnë edhe të drejtën e personave të ndaluar/arrestuar për të bërë ankesa apo kërkesa të natyrave të ndryshme.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisaratin e Policisë Shkodër, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me të shoqëruarit në mjediset e policisë, në zyrat e punës së tyre, për shkak të mungesës të ambienteve të veçanta për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar. Këto zyra, nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave.

Mungesa e dhomës së intervistimit për persona të shoqëruar, ndaluar/arrestuar, është një nga problemet që paraqitet në këtë komisariat. Duke mos siguruar garantimin e lirive të drejtat dhe standardeve që kanë të bëjnë me dëshminë e tyre përpara institucioneve të privimit të lirisë. Duke pasur parasysh faktin se ky institucion sapo është ndërtuar, për të cilën nuk plotëson standardet bashkohore në zbatim të Procedurës Standarde “*Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, në Procedurën Standarde

*“Rregullat teknike të shoqërimit në polici”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.<sup>3</sup>

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimet e mëparëshme ka rekomanduar marrjen e masave për ndërtimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera pranë tyre, por është konstatuar se sërisht ky rekomandim nuk është plotësuar<sup>4</sup>

Proçesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar dhe të ndaluar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Një problematikë e konstatuar nga grupi i inspektimi, kishte të bënte edhe me kohën e vënies në dispozicion të kartës me të drejtat ligjore personave të shoqëruar apo ndaluar në mjediset e policisë. Aktualisht, personat e shoqëruar/ndaluar nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se morën një kopje të fletës me të drejtat e tyre, në përfundim të proçesit të marrjes në pyetje në organin e policisë. Por, DVP edhe Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) i ka rekomanduar institucioneve përgjegjëse të policisë të shtetit gjatë inspektimit të kryer në vitin 2018- të, se personat e shoqëruar/ndaluar duhet të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i privimit të lirisë (momenti i shoqërimit), duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë që në fillim të privimit të lirisë<sup>5</sup>. Sipas gjetjeve të inspektimit edhe të MKPT, karta me të drejtat e personave të ndaluar u jepej atyre në fund të proçesit të marrjes në pyetje dhe jo që në momentin e shoqërimit për në mjediset e komisariatit.

Grupi i inspektimit, evidentoi si një praktikë të mirë në Komisarariatit të Policisë Shkodër, investimin i cili ishte financuar nga Unicef dhe Qeveria Norvegjeze, në kuadrin e programit “Qasja e Fëmijëve në Drejtësi”, mbi bazën e projektit të miratuar nga strukturat përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për krijimin e 2 dhomave të përshtatura për intervistimin dhe regjistrimin për të miturit në konflikt me ligjin. Këto dhoma ndodheshin në katin e 2 së godinës të Komisarariatit dhe ishin të kompletuara dhe të pajisura me të gjitha orënditë e nevojshme si tavolina, kolltuqe, bibliotekë për libra, postera informues, si dhe këto dhoma ishin të monitoruara me sistemin audio viziv, por akoma nuk ishin dorëzuar Komisarariatit të Policisë Shkodër për vënien e tyre në funksion. Gjithashtu, në këtë institucion, ishin trajnuar 2 specialistë vetëm për intervistimin apo marrjen në pyetje të të miturve.

---

<sup>3</sup> Referuar kreu XIV pika 6/b procedurës standarte “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Përcakton se: Në dhomat e intervistimit/marrjes në pyetje të arrestuarve/ndaluarve për tu regjistruar në elektronikë proçesin e marrjes e marrjes në pyetje apo veprimet të tjera procedurale hetimore me të arrestuarit/ndaluarit.

<sup>4</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

<sup>5</sup> Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës ju ka rekomanduar CPT/Inf (2019) 289



Nga monitorimi që iu bë zyrove të punonjësve të policisë në mesin aktual të Komisarariatit të Policisë Shkodër, nuk u gjetën sende, prania e të cilave ekspozonte dhunë, tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

### **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Edhe në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të K.Pr. Penale parashikohet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të cilat u verifikuan gjatë intervistimit të personave të ndaluar/arrestuar nga grupi i inspektimit.

Gjatë inspektimit, rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga ana e punonjësit të policisë mbahej edhe një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”.

Gjithashtu nga mbikëqyrja e fashikullit të dosjes për persona të shoqëruar ndaluar/arrestuar, u konstatua se, zbatohet detyrimi ligjor për të njoftuar personat e ndaluar/arrestuar madhor, që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, ofrohet dhe ndihmë juridike duke siguruar një avokat kryesisht, duke krijuar mundësinë për të kontaktuar me të.

Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë. Për shtetasit e ndaluar/arrestuar me shtetësi të huaj ishin përgatitur postera me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në disa gjuhë të huaja dhe këto materiale gjendeshin edhe në gjuhën shqipe.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut. Psikologu ishte në organikë të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dhe kishte detyrimin të asistonte të miturin deri në përfundim të procedurave përkatëse.

Grupi inspektimit evidentoi mungesën e mjekut në këtë institucion. Ky është një problem thelbësor veçanërisht në kohë të pandemisë. Nga informacioni i marrë nga shefi i rendit, u informuam se shërbimet shëndetësore për personat të arrestuar/të ndaluar kryen nga mjeku i emëruar pranë forcave të ndërhijes së shpejtë (FNSH) Shkodër, si dhe për raste urgjente të ndaluarit/arrestuarit dërgohen në Spitalin Rajonal Shkodër.

Mekanizmi Kombëtar konstaton se mungesa e mjekut në këtë institucion ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e organikës së Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, me një mjek me kohë të plotë, pasi mund të ketë

raste urgjente dhe pasojat mund të jenë të rënda. Ai ka rol thelbësor edhe për të indentifikuar të rasteve të dhunës.

Grupi i monitorimit konstatoi se, vizitat mjekësore nga ana e mjekut kryheshin brenda afatit 12 orë, nga momenti i vendosjes së këtyre personave në ambientin e sigurisë, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”<sup>6</sup>

Vizitat mjekësore ndaj të ndaluarve/arrestuarve, konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Gjithashtu hapeshin edhe kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar.

Gjatë inspektimit u konstatua se, në korridoret e godinës të këtij komisarati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar, por ato duhet të vendosen edhe në vende ku mund të jenë të aksesueshme nga të ndaluarit dhe të shoqëruarit në mjediset e policisë.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

### **REKOMANDIMË :**

1. Marrjen e masave të menjëhershme për gjetjen e fondeve përkatëse për ndërtimin e ambienteve të përshtatëshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes të veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore, në Komisaratin të Policisë së Shkodrës, sipas kritereve të parashikuara në Kreun XIV, pika 6 të procedurave standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin nr. 925, dt. 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në ambientet e brendshme dhe të jashtme të dhomave të ndalim arrestimit vendosen pajisje sigurie(sistem kamerash audio-vizive)për monitorimin e ambienteve dhe të veprimeve të punonjësit të policisë me të ndaluar të arrestuar si dhe çdo aktivitet në këto ambiente.
2. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin e një sistemi cilësor të monitorimit me kamera në zyrat ku merren në pyetje shtetasit e shoqëruar, ndaluar/arrestuar, në Komisaratin e Policisë Shkodër.

---

<sup>6</sup> Kreu V, pika 7.2 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

3. Marrjen e masave të menjëherëshme për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër.
4. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e një ambienti të veçantë për ushtrimin e riteve fetare në ambientet e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër.
5. Marrjen e masave të menjëherëshme për garantimin e masave anti COVID 19, si një problematikë evindente dhe domosdoshme për ruajtjen e shëndetit të punonjësve si dhe të personave të shoqëruar të ndaluar/arrestuar në këtë komisariat.
6. Marrjen e masave të nevojshme për të respektuar të drejtat e personave të shoqëruar, arrestuar/ndaluar, si lejjimin e avokatëve të takohen me këto subjekte në çdo kohë dhe sa herë kërkohen prej tyre, sigurimin e psikologëve dhe avokatëve që në momentet e para të shoqërimit të të miturve, si dhe njoftimin sa më shpejtë të familjarëve për vendndodhjen e tyre.

**KOMISIONER**

**ERMONELA XHAFA**